

## Akti i Themelimit

**"PANTEON HOLDING"**  
**Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)**

Sot, më datë **09/01/2023** e nënshkruara:

- **Znj. Sonila Banda, e bija e Albert-it, e lindur më 11/02/1974, banuese në Rruga Dum Alla 441, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit me numër H45211117N.**

Me vullnetin tim të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "(Ligj i Shoqerive) kam vendosur të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "**PANTEON HOLDING**" (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themeli.

### Emri dhe forma ligjore

#### Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë "**PANTEON HOLDING**" ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(Ligji i Shoqerive

### Selia dhe kohezgjatja

#### Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën **Rruga Dum Alla, Nr 441, Zk. 8140, Nr. Pasurie 1/238 1001, Tiranë**. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Ortakut te vetem

### Objekti i veprimitarisë

#### Neni 3.



- 3.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor si: Agjenci Punesimi, Agjenci martesash, blerje online ose internet.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë sic parashikohet në këtë Statut

### **Kapitali Themeltar**

#### **Neni 4.**

- 4.1. Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 10.000 (Dhjete mijë) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me një vlerë nominale 10.000 (Dhjete mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit.
- 4.2. Ortaku vetëm themelues:

- **Znj. Sonila Banda, e bija e Albert-it, e lindur më 11/02/1974, banues në Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit me numër H4521117N , zotëruese e një kuote të barabartë me vlerë nominale 100%.**

### **Organet drejtuese dhe Administrimi**

#### **Neni 5.**

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:
  - Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
  - Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë: Znj. Sonila Banda e cil e merr këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejte rinnovimi.

### **Dispozita Përfundimtare**

#### **Neni 6.**

- 6.1 Cdo cështje tjeter, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i vetem i Shoqërise, sot më datë 09/01/2023 gjuhën shqipe në dy kopje.

**ORTAKU THEMELUES  
SONILA BANDA**

*Sonila Banda*  
*Ali*